

**RREGULLOJA NR. 2007/22**

**NDRYSHIMI I RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2004/51  
MBI TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999) mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke vepruar me kërkesën e Qeverisë dhe duke u konsultuar me Këshillin Ekonomik dhe Fiskal,

Me qëllim të ndryshimit të Rregullores së UNMIK -ut Nr. 2004/51 të datës 4 Dhjetor 2004 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave për të ndryshuar përkufizimin e njësisë së përhershme,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall si vijon:

Neni 1  
Ndryshim

1.1 Përkufizimi i “njësisë së përhershme” në Nenin 1(1) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/51 të datës 4 Dhjetor 2004 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave do të zëvendësohet me përkufizimin vijues:

“(1) “ Njësi e Përhershme” ka kuptimin e dhënë për të me nenin 1A të këtij ligji;”

1.2 Përkufizimet vijuese shtesë do të shtohen në Nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/51 të datës 4 dhjetor 2004 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave:

“(s) “Pasuri e patundshme” nënkupton të gjitha tokat dhe ndërtesat, dhe të gjitha njësitet brenda ndërtesave sikurse janë apartamentet apo hapësirat për qëllime komerciale; dhe

(t) “pasuri e paluajtshme” nënkupton të gjitha pasuritë e patundshme dhe stabilimentet dhe strukturat nën apo sipër sipërfaqes së tokës dhe të lidhura me tokën.

1.3 Paragrafi (d) i nenit 2 do të fshihet dhe do të zëvendësohet me një paragraf të ri (d) me përshkrimin vijues:

“(d) një person jo-rezident me njësi të përhershme në Kosovë, i nënshtrohet dispozitës së nenit 3.2.”

## Neni 2 Shtesë

Pas Neni 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/51 të datës 4 Dhjetor 2004 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave do të shtohet me sa vijon:

### “Neni 1A Njësi e Përhershme

1A.1 Duke iu nënshtuar dispozitave vijuese të këtij neni, në këtë Rregullore “njësi e përhershme” nënkupton një vend të fiksuar të biznesit përmes së cilit biznesi i një personi jo-rezident tërësisht ose pjesërisht kryhet në Kosovë.

1A.2 Termi Njësi e Përhershme do të përfshijë:

- a) çdo vend i menaxhimit;
- b) çdo degë;
- c) çdo zyrë;
- d) çdo fabrikë;
- e) çdo punishte;
- f) çdo minierë; dhe
- g) çdo burim nafte apo gazi, gurore apo vend eksplorimi i resurseve natyrore.

1A.3 Termi “njësi e përhershme” gjithashtu përfshinë:

(a) cilindo vend ndërtimi, projekt konstruksioni, montimi apo instalimi ose aktivitete mbikëqyrëse në lidhje me këtë, por vetëm nëse vendi tillë, projekt apo veprimtari që zgjasin më shumë se 183 ditë. Nëse vendi, projekti, apo veprimtaria zgjat më shumë se 183 ditë, përfshirë veprimtaritë përgatitore, vendi, projekti apo

aktiviteti do të gjykohet të jetë një njësi e përhershme nga dita kur puna e tillë ka filluar;

(b) dhënien e cilido shërbim, përfshirë cilindo shërbim konsultativ, por duke përjashtuar cilëndo veprimtari mbikëqyrëse që referohet në nenin 1A3(a), të kryer në Kosovë nga një person jo-rezident përmes punëtorëve apo personelit tjetër, por vetëm nëse veprimtaritë e tilla vazhdojnë përbrenda Kosovës për një periudhë apo periudha që gjithsej bëjnë 90 ditë apo më tepër përbrenda çdo periudhë dymbëdhjetë mujore. Nëse veprimtaritë vazhdojnë përbrenda Kosovës për një periudhë apo periudha që gjithsej bëjnë 90 ditë apo më shumë brenda periudhë dymbëdhjetë mujore, veprimtaritë do të gjykohen të kenë krijuar një njësi të përhershme nga dita kur veprimtaritë e tilla të kenë filluar;

(c) cilindo vend të shfrytëzuar për kërkime të burimeve natyrore përbrenda në Kosovë, nëse veprimtaritë e tilla përbrenda Kosovës vazhdojnë për një periudhë apo periudha që gjithsej bëjnë 183 ditë apo më shumë brenda cilësdo periudhë dymbëdhjetë mujore. Nëse veprimtaritë vazhdojnë për një periudhë apo periudha që gjithsej bëjnë 183 ditë apo më tepër brenda çdo periudhe dymbëdhjetë mujore, veprimtaritë do të gjykohen të kenë krijuar një njësi e përhershme nga dita kur veprimtaritë e tilla kanë filluar;

(d) cilëndo pasuri të paluajtshme e vendosur në Kosovë dhe në pronësi nga një person jo-rezident.

1A. 4 Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1A.1 dhe 1A.2 të këtij neni, ku një person, ndryshe nga një agjent me një status të pavarur për të cilin paragrafi 1A.7 aplikohet, vepron në Kosovë në emër të një personi jo-rezident, personi jo-rezident do të gjykohet të ketë një njësi të përhershme në Kosovë në lidhje me veprimtaritë që ai person ndërmerr për personin jo-rezident, nëse personi i tillë:

(a) ka dhe ushtron rregullisht autoritet në Kosovë për të përfunduar kontrata në emër të personit jo-rezident, përveç nëse veprimtaritë e personit të tillë janë të kufizuara në ato të përmendura në paragrafin 1A.6 të cilat, nëse ushtrohet përmes një vendi të fiksuar të biznesit, nuk do ta bënin këtë vend të fiksuar të biznesit një njësi të përhershme sipas dispozitave të atij nën-paragrafi: apo

(b) nuk ka autoritet të tillë, por rregullisht mban në Kosovë rezerva të mallrave apo artikujve nga të cilat ai rregullisht shpërndanë mallra apo artikuj në emër të ndërmarrjes.

1A.5 Një person jo-rezident, që ofron sigurim, përveç në lidhje me ri-sigurimin , do të gjykohet të ketë një njësi të përhershme në Kosovë nëse mbledh prime në Kosovë apo siguron rreziqe të vendosura në Kosovë përmes një personi ndryshe nga një agjent me një status të pavarur për të cilin Neni 1A.7 aplikohet.

1A.6 Pavarësisht nga nën-nenet 1A.1, 1A.2 dhe 1A.3 të këtij neni, “njësi e përhershme” do të gjykohet të mos përfshijë:

(a) përdorimi i objekteve vetëm për qëllim të deponimit apo ekspozimit të mallrave ose artikujve që i personit jo-rezident;

(b) mbajtja e rezervave të mallrave ose artikujve që i përkasin personit jo-rezident vetëm për qëllim të deponimit apo ekspozimit;

(c) mbajtja e rezervave të mallrave ose artikujve që i përkasin personit jo-rezident vetëm për qëllim të përpunimit nga tatimpaguesi tjetër;

(d) mbajtja e një vendi të fiksuar të biznesit vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose artikujve apo në mbledhjen e informative, për personin jo-rezident;

(e) mbajtja e një vendi të fiksuar të biznesit vetëm për qëllim të kryerjes, për personin jo-rezident, të cilitdo aktiviteti tjetër të karakterit përgatitor apo ndihmës; dhe

(f) mbajtja e një vendi të fiksuar të biznesit vetëm për qëllim të ndonjë kombinimi të aktiviteteve të përmendura në nën-paragrafët (a) deri (e) të këtij nën-neni, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të fiksuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim është vetëm i një karakteri përgatitor apo ndihmës;

1A.7 Një person jo-rezident nuk do të gjykohet të ketë një njësi të përhershme në Kosovë vetëm pse kryen biznes në Kosovë përmes një brokeri, agjenti të përgjithshëm komisionar apo ndonjë agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që personat e tillë të veprojnë në rrjedhë të zakonshme të biznesit të tyre. Megjithatë, kur veprimtaritë e një agjenti të tillë janë kushtuar krejtësisht apo pothuajse krejtësisht në emër të atij tatimpaguesi, dhe kushtet janë bërë apo janë vënë në mes të atij tatimpaguesi dhe agjentit në marrëdhëniet e tyre komerciale dhe financiare që ndryshojnë nga ato që do të ishin bërë në mes të tatimpaguesve të pavarur, ai nuk do të konsiderohet një agjent me status të pavarur përbrenda kuptimit të këtij nën-neni.

1A.8 Fakti se një person jo-rezident kontrollon apo kontrollohet nga një kompani e cila është rezidente e Kosovës, apo i cili kryen biznes në Kosovë (qoftë përmes një njësie të përhershme apo ndryshe), vetë nuk do të përbëjë kompani apo njësi të përhershme të tjetrit.

### Neni 3 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 6 gusht 2007.

Joachim Rücker  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm